



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# PASOJAT E MOSFALJES SË NAMAZIT

Dr. Jusuf Kardavi

Botuar nga: SHB SIRA

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

## PARATHËNIE

Lavd-Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave.

Paqja qoftë mbi të dërguarin e Tij, Muhammedin, mbi ne dhe mbi të gjithë robërit dhe adhuruesit e All-llahut.

Fatkeqësisht, në kohë të fundit po hasim në besimtarë të cilët nuk e praktikojnë faljen, e ka prej tyre që as nuk e dinë se falja, përkatësisht namazi është kushti – obligimi i dytë për të qenë musliman pas dëshmisë se nuk meriton të adhurohet askush tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i Tij. Për këtë gjithsesi kanë ndikuar shumë edhe rrethanat shoqërore, por tanimë kur ekziston një literaturë mjaft e pasur që sqaron kushtet për të qenë besimtar, është e palogjikshme që në Ditën e Gjykimit të dilet me arsye të padijenisë për mos-respektimin e faljes.

A thua ne mundemi t'i fshehim diçka Atij që e di të dukshmen dhe të fshehtën? Për këtë shkak vendosëm që ta ribotojmë librin *Pasojat e mosfaljes së namazit* me qëllim që i painformuari të informohet, ndërsa ai që ka harruar të përkujtohet.

Besojmë se broshura do të mirëpritet nga lexuesit e nderuar...

## **PYETJA:**

Si duhet ta trajtojmë individin, i cili thotë se është musliman, por nuk falet dhe nuk agjëron? A jemi të obliguar ta përshëndesim me selam dhe kur të vdes t'ia falim xhenazen?

## **JUSUF KARDAVI:**

Kjo i ngjan shembullit të njeriut, i cili caktohet nga shoqëria të cilës i takon për kryerjen e ndonjë detyre, për të cilën do të shpërblehet nëse e kryen me rregull, por edhe bëhet përgjegjës për kryerjen e atij obligimi. Megjithatë, nëse ky njeri nuk e kryen detyrën e besuar, edhe pse është i shëndoshë mendërisht dhe fizikisht, d.m.th. e lë punën pa arsye, atëherë ky njeri mund të gjykohet në dy mënyra:

1. Me largim nga vendi i punës për shkak të mosrespektimit të punës, ose
2. Me dënim më të butë se largimi nga puna, nëse nuk i ka nënçmuar publikisht obligimet e veta.

Kështu sqarohet qëndrimi i dijetarëve islam mbi muslimanin i cili me vetëdije nuk i kryen obligimet fetare, e posaçërisht faljen e pesë namazeve gjatë ditës. Disa prej tyre konsiderojnë se obligimi thelbësor i çdo muslimani, e madje çdo njeriu në jetën e tij është përulja vetëm All-llahut të Lartësuar. Mosnënshtrimi ndaj Allahut konsiderohet si tradhti e detyrës më qenësore të një

muslimani dhe për këtë shkak individi i tillë nuk meriton të mbajë emër muslimani e as të gjendet nën mbrojtjen e Islamit.

Këtë mendim e përforcojnë edhe këto thënie të besueshme të të Dërguarit fisnik:

“Mes njeriut dhe pabesimit është lënia e namazit”.

“Ajo me çka dallohem i me ta (pabesimtarët) është namazi, pra kush e le namazin është pabesimtar”.

Disa dijetarë tjerë konsiderojnë se nëse individi i cili ka lënë pas dore ndonjë obligim Islam duke mos e përbuzur atë, ndërsa kohë pas kohe e kryen, duke u penduar për lëshimet e veta dhe duke synuar kah përmirësimi, do të trajtohet si musliman.

Sipas asaj që deri tani thamë, ata që e lënë faljen, e bëjnë këtë nga dy shkaqe:

1. Për shkak se *mohojnë* se namazi është obligim dhe nuk i kushtojnë kurrfarë rëndësie atij. Të tillët sipas mendimit unanimit të dijetarëve Islam trajtohen si pabesimtarë dhe renegatë, sepse roli dhe rëndësia e namazit në islam janë të njohura.

Pra, çdonjëri që mohon, nënçmon dhe përgënjeshton urdhrin e Zotit dhe të Dërguarit të Tij trajtohet si pabesimtar, në zemrën e të cilit nuk ka besim (iman) as sa kokrra e grurit. Për këtë lloj të njerëzve All-llahu xh.sh. thotë:

“...kush e kundërshton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, i tij është zjarri i xhehenemit, aty do të jenë përgjithmonë, pambarim.”<sup>1</sup>

“Edhe thirrjen (ezanin) tuaj për namaz ata e marrin për tallje e lojë. Me këtë vërtetojnë se janë popull që nuk kupton”<sup>2</sup>

Këto ajete mjaft mirë e përshkruajnë pozitën e atyre që namazin dhe ibadetet tjera i konsiderojnë si shenja prapambeturish dhe dekadencës, duke i përqeshur ata që falen.

2. Nuk e kryejnë faljen nga përtacia, të preokupuar me këtë botë, duke shkuar pas epsheve të veta dhe mashtrimeve të shejtanit.

Rreth kësaj çështjeje dijetarët islam kanë dhënë këto përgjigje:

Ebu Hanife:

“Personi i tillë do të konsiderohet si mëkatar dhe do të jetë e domosdoshme që të riedukohet me rrahje aq sa t’i rrjedhë gjak, e mandej të izolohet (burgoset) derisa të fillojë të falet. Njëjtë do të veprohet edhe me atë që pa shkak të arsyeshëm ushqehet gjatë ditëve të Ramazanit”.

Maliku dhe Shafiu:

---

<sup>1</sup> Kur’ani: Xhinn, 23

<sup>2</sup> Kur’ani: Maide, 58

“Njeriu i tillë është mëkatar. Ai nuk do të konsiderohet si pabesimtar, por edhe dënimi me rrahje dhe burgosje nuk do të mjaftojë, nëse është kokëfortë në qëndrimin e tij, do të dënohet me vdekje.”

Ahmed ibn Hanbeli:

“Personi i tillë është pabesimtar dhe renegat. Ai do të dënohet me vdekje, por para kësaj do të kërkohet prej tij t’i pendohet Zotit dhe të falë namazin. Nëse e pranon këtë kusht, do të lirohet, në të kundërtën do t’i ekzekutohet dënimi”.

Kuptohet, mendimi i këtyre dijetarëve bazohet në Kur’an dhe në hadithe të besueshme.

Në Kur’an theksohet edhe rasti, i cili tregon gjendjen e mohuesve në Ditën e Gjykimit:

“Atë ditë është mjerim për ata që mohuan të mirat e Zotit. Dhe kur atyre u thuhej: “Përkuluni!” ata nuk përkuleshin.

Atë ditë është mjerim për ata që përgënjeshtuan!”<sup>3</sup>

Se si do të ndihet pabesimtari në Ditën e Gjykimit përshkruan ky ajet:

“(Përkujto) Ditën kur ashpërsohet çështja deri në kulm (në kiamet), e ata do të ftohen për të bërë sexhde, por nuk do të munden. Shikimet e tyre janë të përlulura dhe ata i kaplon poshtërimi, kur dihet se ata kanë qenë të ftuar të bëjnë sexhde sa ishin të shëndoshë (e ata talleshin).<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Kur’ani: Murselatë, 47-49

<sup>4</sup> Kur’ani: Kalem, 42-43

Allahu i Lartmadhëruar për politeistët thotë:

“Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë lëshoni rrugën, se vërtet All-llahu falë, është Mëshirues”.<sup>5</sup>

Gjithashtu përshkruhet edhe dialogu mes besimtarëve dhe pabesimtarëve në Ditën e Gjykimit:

“Çka ju solli juve në Sekar?<sup>6</sup> Ata thonë: Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz); Nuk kemi qenë që ushqenim të varfrit; Dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota. Dhe kemi qenë që nuk besonim Ditën e Gjykimit. Derisa na erdhi e vërteta (vdekja)!”<sup>7</sup>

Pra gjëja e parë që do t’i fus në zjarr do të jetë moskryerja e faljes.

Ajeti vijues na tregon virtytet e dyfytyrëshve:

“Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtar), por All-llahu mbizotëron dinakëritë e tyre. Ata edhe kur falen, falen me përtaci dhe vetëm sa për t’u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin All-llahun!”<sup>8</sup>

Gjithashtu, nëse u drejtohem haditheve të të Dërguarit fisnik, mund të vërejmë se edhe ato e vlerësojnë si pabesimtar atë që me vetëdije le pas dore faljen. Ndër hadithet që trajtojnë këtë temë numërohen edhe këto:

---

<sup>5</sup> Kur’ani: Teube, 5

<sup>6</sup> Sekar: emër i xhehennemit më të ashpër

<sup>7</sup> Kur’ani: Muddeththir, 42-47

<sup>8</sup> Kur’ani: Nisa, 142

“Mes njeriut dhe pabesimit është lënia e faljes”<sup>9</sup>

“Ajo me çka dallohem nga ata (pabesimtar) është namazi. Kush e lë atë (namazin) bëhet pabesimtar.”<sup>10</sup>

“Kurrë mos e lë ndonjë namaz me vetëdije, sepse ai që e lë namazin me vetëdije është i privuar mbrojtjes së All-llahut!”

“Kush rregullisht e kryen namazin do t’i jetë dritë, shpëtim dhe dëshmi në Ditën e Gjykimit, e kush nuk e kryen rregullisht atë, nuk do të ketë dritë, shpëtim e as dëshmi dhe në Ditën e Gjykimit do të jetë në shoqërinë e Karunit, Faraonit, Hamanit dhe Ubej ibn Halefit”<sup>11</sup>

“Atij që i kalon namazi i ikindisë është sikur ai, të cilit i është gjymtuar (cunguar) familja dhe pasuria e vet.”<sup>12</sup>

---

<sup>9</sup> Këtë hadith e transmeton Muslimi nga Xhabiri r.a.

<sup>10</sup> Hadithi është transmetuar në Sunenet, ndërsa Ahmed ibn Hanbeli e transmeton nga Burejde r.a.

<sup>11</sup> Hadithi transmetohet nga Abdullah ibn Umeri r.a., ndërsa Ahmedi dhe Hajthemi thonë se është i besueshëm. Në transmetimin e hadithit, Ibn Kajjimi thotë se atë që nga falja e largon dëshira për pushtet, do të jetë i ringjallur pranë faraonit; ai që e ka lënë namazin nga dëshira për pasuri do të ringjallet pranë Karunit; atë që kryelartësia dhe pozita e kanë penguar nga falja do të ringjallet në shoqëri me Hamenin, ndërsa nëse është në pyetje tregtia, atëherë do të ringjallet pranë Ubejje ibn Halefit. Pra, ai që e lë ndonjë namaz me qëllim do të ringjallet me këta njerëz të këqij, të cilët në histori janë regjistruar si tiranë. Por, a thua çdo të ndodhë me ata njerëz që asnjëherë në jetë nuk i janë përlulur Krijuesit të tyre (në sexhde)!!! Mendo për këtë!!!!

“Për dyfytërshët (munafikët) nuk ka namaz më të rëndë se sabahu dhe jacia (në xhami), e po ta dinin se çfarë shpërblime kanë për to, do t’i falnin edhe duke shkuar zvarrë.

Kam vendosur që t’i urdhëroj myezinit të bëj ikamet, e t’i urdhëroj ndonjërit t’i bëhet imam xhematit, ndërsa unë t’i marrë disa gaca nga zjarri dhe t’ia ndez (shtëpinë) atij që ende nuk ka dalë (në xhami për namaz)!”<sup>13</sup>

Gjithashtu, edhe as’habët<sup>14</sup>, pa përjashtime konsiderojnë se personi që nuk falet duhet trajtuar si pabesimtar dhe murted (renegat).

Abdullah ibn Shekik el-Ukajli r.a ka thënë:

“As’habët e Muhammedit a.s. konsiderojnë se obligimi i vetëm, lënia e të cilit shpie në pabesim është namazi”<sup>15</sup>.

Aliu r.a. ka thënë:

“Ai që nuk falet është pabesimtar”

---

<sup>12</sup> Hadithin e transmeton Buhariu në “Sahih”. Pra, nëse ai që nuk e fal vetëm një namaz i ngjan atij që i është shkatërruar familja dhe pasuria, a thua kujt i ngjan ai që nuk e ka falur asnjë namaz në jetën e tij???!?

<sup>13</sup> Edhe këtë hadith e transmeton Buhariu në “Sahih”. Ky hadith rreptë ua tërheqë vëmendjen atyre që nuk falen me xhematë (në xhami).

<sup>14</sup> Shprehja Sahabe – As’habë simbolizon ata që e panë Muhammedin a.s. duke qenë me besim dhe vdiqën në atë gjendje.

<sup>15</sup> Transmeton Tirmidhiu

Ibn Abbasi r.a.:

“Kush e lë pas dore namazin është bërë pabesimtar!”

Ibn Mes’udin r.a.:

“Kush e lë pas dore namazin, nuk ka fe”

Xhabir ibn Abdullahu r.a.:

“Pabesimtar është ai që nuk falet”

Ebu Derda r.a.:

“Nuk ka fe ai që nuk e praktikon namazin, dhe nuk ka namaz ai që nuk ka marrë abdes!”

Is’hak ibn Ruvejhi:

“Me besnikëri është transmetuar nga i Dërguari i All-llahut a.s. se ai që nuk falë namaz është pabesimtar, por gjithashtu pabesimtar konsiderohet edhe ai që me vetëdije dhe pa arsye e shtyn faljen e namazit.”<sup>16</sup>

Ejjub es-Sahtijani r.a. thotë:

“Është e padyshimtë se lënia e namazit është pabesim!”

Hafidh Mundhiri, pas të theksuarit të haditheve dhe thënieve të as’habëve mbi këtë temë, thotë:

---

<sup>16</sup> Transmeton Muhammed ibn Nasr el-Mervezi

“Një grup i as’habëve dhe tabi’inëve<sup>17</sup> i konsiderojnë si pabesimtarë edhe ata që e shtyjnë faljen e namazit deri atëherë sa nuk kalon koha e tij. Mes këtyre gjenden edhe: ‘Umeri, ibn Mes’udi, ibn Abasi, Muadh ibn Xhebeli, Xhabir ibn Abdullahu, Ebu Derda, Ahmed ibn Hanbeli, Is’hak ibn Ruvejhi, Abdullah ibn Mubareku, Ibrahim en-Nehai, Hakim ibn Utejbe, Ejjub es-Sahtijani, Ebu Davud et-Tajalisi, Ebu Bekr ibn Ebi Shejbe, Zuhejr ibn Harbi dhe të tjerë, (Zoti qoftë i kënaqur me ta)”.

Këto janë mendime të transmetuara nga dijetarët e njohur Islam, tabi’inët dhe as’habët për pabesimin e atij i cili qëllimisht, qoftë edhe një namaz e le pa e falë, e çfarë është atëherë qëndrimi i tyre ndaj atij i cili ka kaluar vite të tëra duke mos e përkulur kurrizin kurrë që t’i bie në sexhde All-llahut xh.sh.

Pas gjithë kësaj që theksuam, mund të përfundojmë se ai i cili nuk e kryen namazin është:

-Pabesimtar, nëse nuk falet duke e përbuzur kryerjen e namazit dhe rëndësinë e tij, ose:

-Mëkatari i madh, (e sipas disave përsëri pabesimtar), nëse nuk e kryen atë për shkak të dhënies pas epsheve dhe dëshirave të veta.

- Sipas mendimit më të butë, personi i tillë është mëkatari, i cili nuk është larg as nga kufri (pabesimi), sepse nuk ka dyshim se mëkatet shpijnë njëri në tjetrin, të vegjlit nxisin në të mëdhenj, dhe kështu lehtë arrihet në pabesim.

---

<sup>17</sup> Tabi’inë - pasardhësit e as’habëve

Për këtë shkak, është e domosdoshme që çdo njeri që ndihet si musliman ndërsa nuk e fal namazin, t'i rishqyrtojë veprat dhe rrugën e tij, t'i pendohet All-llahut xh.sh dhe ta përforcojë besimin me kryerjen e përhershme të namazit, njëlloj siç është e domosdoshme që besimtarët ta këpusin çdo kontakt me ata që me këmbëngulje qëndrojnë në mendimin se namazi nuk është obligim i muslimanit. Gjithsesi, kjo vlen nëse besimtarët i kanë këshilluar më parë ata, ndërsa ata nuk i kanë pranuar këshillat e tyre me kokëfortësi.

Ibn Tejmije, për atë që nuk falet thotë:

“Nuk duhet t'i jepni selam, e as t'i përgjigjeni ftesës së tij, as nuk është e lejuar që babai t'ia jap vajzën e tij, për shkak se nëse ai nuk falë namaz në të vërtetë nuk është musliman, nuk meriton grua muslimane, e as fëmijë muslimanë!”

Madje nuk është e lejuar që t'i jepet punë atij që nuk falë namazin, sepse me këtë do ta ndihmoje që të përdorë begatitë e All-llahut xh.sh për të bërë mëkat ndaj Tij.

Nuk ka dyshim se personi që nuk i kryen obligimet e veta ndaj Krijuesit të vet, aq më pak nuk do t'i kryejë obligimet me nder edhe ndaj krijesave tjera.

Namazi paraqet shtyllën kryesore të fesë, për moskryerjen e së cilës nuk ka ndjesë, përveç kur personi e humbë vetëdijen dhe nuk di se çka flet, e të gjitha sëmundjet tjera nuk janë arsye e mjaftueshme që namazi të mos falet, qoftë edhe nëse personi është i paralizuar apo rëndë i plagosur.

Sipas Ligjit Islam (shariatit) të sëmurit duhet thënë:

“Pastrohu si dhe sa të mundesh. Ulu qysh të mundesh, por mos e lësho namazin. Pastrohu me ujë, e nëse nuk mundesh merr tejemmum<sup>18</sup>, me dhe të pastër. Falu në këmbë, nëse kështu nuk mundesh, falu ulur, nëse nuk mundesh as kështu, falu i mbështetur në anën e djathtë apo i shtrirë në shpinë, e nëse as kështu nuk mundesh, atëherë lëvize kokën ose vetëm sytë, në kuptim të fjalëve të All-llahut xh.sh:

“Andaj, sa te keni mundësi ruajuni prej dënimit të All-llahut!”<sup>19</sup>

Në përputhje me atë që thamë, vërejmë përgjegjësinë e mbarë shoqërisë për moskryerjen e këtij obligimi, e sidomos të çdo individit në kuadër të kompetencave të veta: babai është përgjegjës për djemtë dhe vajzat e moshës jomadhore, burri për gruan e tij, etj.

All-llahu xh.sh. thotë:

“Urdhëro familjen tënde që të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde). Ne të furnizojmë ty (dhe ata) ardhmëria e mirë është e atij që ruhet”.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Urdhëroni fëmijëve tuaj të falin namaz që prej moshës shtatë vjeçare, e kur t’i mbushin dhjetë vjet, atëherë detyroni.”

Gjithashtu All-llahu xh.sh. thotë:

---

<sup>18</sup> Tejemmum - pastrim me dhe të pastër

<sup>19</sup> Kur’ani: Tegabun, 16

“O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj nga zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!”<sup>20</sup>

Nëse me të vërtetë bashkëshorti e do gruan e tij, ndërsa babai fëmijët e tij, dhe nuk dëshirojnë që t’i humbin, atëherë le t’i mbrojnë nga zjarri duke u urdhëruar nënshtrim Krijuesit të tyre, para së gjithash me kryerjen e namazit.

\* \* \*

Na ka mbetur edhe një çështje, të cilën jemi të obliguar ta shpjegojmë, e kjo është se a jemi të obliguar t’ia falim xhenazen atij që nuk e ka falur namazin...

Kjo çështje gjithsesi varet se a ka qenë njeriu pabesimtar, ose vetëm mëkatar i rëndë.

Sipas mendimit të dijetarëve, nëse njeriu që ka vdekur ka qenë i thirrur nga Imami (kryetari) i asaj kohe ose gjykatësi i shariatit (si zëvendës i tij) që ta falë namazin, e ky nuk ka pranuar, atëherë nuk do t’i falet namazi pasi që do të konsiderohet si pabesimtar. Kjo vlen për njeriun i cili përveç namazit ka bërë edhe lëshime të tjera, siç janë pandershmëria (imoraliteti) dhe moskryerja e obligimeve tjera islame.

Megjithatë, nëse personi nuk e ka mohuar namazin si obligim, ndonjëherë është falur e ndonjëherë jo, atëherë këtij personi do t’i falet namazi dhe i njëjti do të varroset në varrezat e muslimanëve.

\* \* \*

---

<sup>20</sup> Kur’ani: Tahrim, 6

U apelojmë besimtarëve, të cilët deri tani nuk kanë praktikuar namazin nga shkaqe të ndryshme që t'i drejtohen sinqerisht Krijuesit të tyre - All-llahut Fuqiptotë me pendim, dhe të fillojnë praktikimin e këtij obligimi të domosdoshëm për çdo besimtar. Nuk ka dyshim se Ai është Mëshiruesi, Falësi i mëkateve, i Cili me kënaqësi do t'ua pranojë pendimin e sinqertë dhe do t'ua falë mëkatet e mëparshme insha- All-llah.